



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 01/140
Datë: 05.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkripteve nga mbledhjet 135 dhe 136 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/140
Datë: 05.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Mekanizmat Institucionalë për Mbrojtje nga Diskriminimi në Qeveri dhe Komuna.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 03/140
Datë: 05.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.
2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/140
Datë: 05.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në emër të dy Bashkëshortëve.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr.05/140
Datë: 05.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtarë të Bordit Drejtues të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, emëron:
 - 1.1. Shqipe Dema, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtare;
 - 1.2. Isuf Cikaqi, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar;
 - 1.3. Parim Bajrami, Oda Ekonomike e Kosovës, anëtar;
 - 1.4. Tahire Maloku - Gjergji, Ministria e Shëndetësisë, anëtare;
 - 1.5. Selvete Krasniqi, Ministria e Shëndetësisë, anëtare;
 - 1.6. Selatin Kaçaniku, Shoqata Konsumatori, anëtar;
 - 1.7. Valdet Gjinovci, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, anëtar.
2. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë 3 (tre) vite.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/140
Datë: 05.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtar të Këshillit Shkencor të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, emëron:
 - 1.1. Naser Ramadani, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, anëtar;
 - 1.2. Betim Bresilla, Instituti Bujqësor i Kosovës, anëtar;
 - 1.3. Dilaver Salihi, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore, anëtar;
 - 1.4. Arben Mehmeti, Fakultetit i Bujqësisë dhe Veterinarisë, anëtar;
 - 1.5. Hajrip Mehmeti, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, anëtar;
2. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë 3 (tre) vite.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Nr. 07/140
Datë: 05.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 12 të Ligjit Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT PËR KOMUNITETE

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i Programit për Komunitete është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për ndarjen e subvencioneve apo transfereve nga buxheti i ndarë për Zyrën për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit (në tekstin e mëtejshëm: Programi), me qëllim të mbështetjes dhe promovimit të të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës.

Neni 2
Fushëveprimi

1. Programi zbatohet nga Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK) në Zyrën e Kryeministrit dhe nga të gjithë personat fizikë apo juridikë të cilët janë përfitues të subvencioneve apo transfereve.
2. Buxheti i ndarë për ZÇK-në në Zyrën e Kryeministrit, kategoria subvencione dhe transfere (në tekstin e mëtejshëm: subvencione) shfrytëzohet në pajtim të plotë me këtë Program.

Neni 3
Parimet

1. Gjatë procesit të ndarjes së subvencioneve, duhet të respektohen parimet si në vijim:
 - 1.1. Liria e pjesëmarrjes në konkurrim;
 - 1.2. Mos diskriminimi dhe trajtimi i barabartë;
 - 1.3. Transparenca e procedurave të vendimmarrjes, duke ju ofruar të gjithë aplikuesve të dhënat e kërkuara;

- 1.4. Përputhshmërinë me objektivat e subvencionit, me efektivitetin e përdorimit të burimeve në bazë të sistemit të konkurrimit dhe kriterëve, që mundësojnë vlerësimin e kërkesave apo projekt propozimeve dhe specifikave teknike e financiare për përzgjedhjen dhe shpërndarjen e subvencionit;
- 1.5. Paanshmërinë e shqyrtimit të vendimmarrjes dhe parandalimin e konfliktit të interesit;
- 1.6. Përfundimin e mbivendosjes që nënkupton ndalimin e financimit të së njëjtit përfitues më shumë se një herë brenda një viti.

Neni 4

FTESA PËR PROPOZIME PËR ORGANIZATAT JO QEVERITARE

1. ZÇK çdo vit shpallë ftesë për propozime me qëllim të përkrahjes financiare të Organizatave Jo Qeveritare (në tekstin e mëtejme: OJQ), të cilat merren me mbrojtjen, avancimin dhe promovimin e të drejtave të Komuniteteve në Republikën e Kosovës.
2. Ftesa për propozime shpallet një herë brenda vitit në ueb faqen e ZÇK-së dhe në mediat elektronike apo të shtypura, dhe të drejtë aplikimi kanë të gjitha OJQ-të e regjistruara në organin kompetent në Republikën e Kosovës, të cilat i plotësojnë të gjitha kushtet për aplikim, të përcaktuara nga ZÇK, në pajtim me këtë Program.
3. OJQ-të i dorëzojnë formularët e plotësuar për aplikim në ZÇK në formë fizike apo elektronike në njërin nga gjuhët zyrtare brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas datës së publikimit të ftesës për propozime.

Neni 5

Kushtet për aplikim të OJQ-ve

1. OJQ-të që aplikojnë në ftesën për propozime të shpallur nga ZÇK, me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë dokumentet si në vijim:
 - 1.1 formularin e aplikimit që merret në ueb faqen e ZÇK-së
 - 1.2 certifikatën e regjistrimit të OJQ-së në organin kompetent në Republikën e Kosovës
 - 1.3 certifikatën e numrit fiskal;
 - 1.4 letërnjoftimin e vlefshëm të udhëheqësit të OJQ-së apo të personit të autorizuar, të lëshuar nga organi kompetent në Republikën e Kosovës;
 - 1.5 raportin e gjashtë (6) mujorit të fundit të llogarisë bankare të OJQ-së;
 - 1.6 si dhe dokumente apo dëshmi të burimeve tjera të financimit/mbështetjes nga donatorët tjerë, sipas kërkesës së ZÇK-së.

Neni 6

Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve të OJQ-ve

1. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit me Vendim themelon Komisionin për shqyrtimin e aplikacioneve të OJQ-ve (në tekstin e mëtejme: Komisioni) të cilat aplikojnë për përfitimin e subvencioneve në ZÇK.
2. Komisioni i lartpërmendur përbëhet nga pesë (5) anëtarë.

Neni 7

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni ka për detyrë të zhvillojë të gjitha procedurat për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të dorëzuara nga OJQ-të, dhe të bëjë përzgjedhjen e OJQ-ve fituese të cilat i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara.

2. Komisioni brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh i kryen të gjitha procedurat e shqyrtimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së OJQ-ve fituese.
3. Pas përzgjedhjes së OJQ-ve fituese, Komisioni në afat prej tre (3) ditësh njofton ZÇK-në për listën e OJQ-ve fituese.
4. Komisioni për punën e tij i raporton Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.

Neni 8 **Kriteret për përzgjedhjen e OJQ-ve përfituese**

1. Komisioni me rastin e shqyrtimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së OJQ-ve fituese, duhet t'i ketë parasysh kriteret si në vijim:
 - 1.1 plotësimin e kushteve dhe kriterëve të përgjithshme nga OJQ-ja me rastin e aplikimit;
 - 1.2 përvojën dhe kapacitetet e OJQ-së në zbatimin e projekteve paraprake;
 - 1.3 pritshmërinë dhe koston.

Neni 9 **Shpallja e OJQ-ve përfituese**

Pas përfundimit të procedurave të përzgjedhjes, Komisioni shpallë listën e OJQ-ve përfituese, të cilën në afat prej tre (3) ditësh e dorëzon në ZÇK, me qëllim të njoftimit dhe publikimit të asaj liste në ueb faqen zyrtare të ZÇK-së.

Neni 10 **Procedura e ndarjes së mjeteve tek OJQ-të përfituese**

OJQ-së përfituese pas nënshkrimit të marrëveshjes me ZÇK, do t'i ndahen mjetet financiare për zbatimin e projektit në pajtim me këtë Program. Ndarja e mjeteve financiare bëhet pas dërgimit të raporteve të rregullta sipas kërkesës së ZÇK-së, dhe siç parashihet me marrëveshje.

Neni 11 **Monitorimi i zbatimit të projekteve të OJQ-ve**

1. Monitorimi i zbatimit të projekteve bëhet nga Komisioni monitorues, i cili themelohet me Vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.
2. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë.
3. OJQ-të përfituese të projekteve, janë të obliguara të dorëzojnë raport narrativ në ZÇK për ecurinë e projektit, ndërsa 30 ditë pas realizimit të projektit janë të detyruar të dorëzojnë raportin përfundimtar narrativ, raportet financiare, dhe të ofrojnë dëshmi (kupon fiskal dhe dëshmi tjera) që dëshmojnë se projekti është realizuar sipas planit, dhe në pajtim të plotë me këtë Program.
4. OJQ-të përfituese të projekteve, me rastin e dorëzimit të raportit narrativ në ZÇK, raportit narrativ duhet t'ia bashkëngjisin edhe dokumentet, si në vijim:
 - 4.1 letërnjoftimin e vlefshëm të udhëheqësit të OJQ-së apo të personit të autorizuar, të lëshuar nga organi kompetent në Republikën e Kosovës;
 - 4.2 përshkrimin në mënyrë të detajuar të projektit;

- 4.3 faturat origjinale me numër fiskal;
- 4.4 pagesat e kryera nëpërmjet njërës prej bankave të licencuara në Republikën e Kosovës;
- 4.5 Marrëveshjet eventuale të cilat i ka nënshkruar me ndonjë organizatë tjetër për implementimin e projektit
- 4.6 dhe dokumente tjera sipas nevojës dhe kërkesave nga ZÇK.

5. Në rast se OJQ-të përfituese nuk i përmbahen kërkesave të lartcekura, marrëveshja e nënshkruar do të anulohet dhe do të ndërmerren veprimet përkatëse ligjore për keqpërdorimin dhe keq menaxhimin e parasë publike, si dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi do të kërkohet kthimi i mjeteve financiare të cilat i ka përfituar OJQ-ja me qëllim të realizimit të projektit.

Neni 12

FONDI PËR MBËSHTETJEN E MEDIAVE TË KOMUNITETEVE

1. ZÇK shpallë konkurs për aplikim, me qëllim të përkrahjes financiare të mediave të cilat merren me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të Komuniteteve në Republikën e Kosovës.
2. Konkursi publik shpallet një herë brenda vitit në ueb faqen e ZÇK-së, në mediat elektronike dhe të shtypura, dhe të drejtë aplikimi kanë të gjitha mediat e komuniteteve, të cilat i plotësojnë kushtet për aplikim të përcaktuara nga ZÇK, në pajtim me këtë Program.
3. Mediat për Komunitete formularët e plotësuar i dorëzojnë në ZÇK në formë fizike apo elektronike në njëërën nga gjuhët zyrtare brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas datës së shpallur të konkursit publik.

Neni 13

Kushtet për aplikim

1. Mediat që aplikojnë në konkursin publik, duhet t'i plotësojnë kushtet si në vijim:
 - 1.1 formularin e aplikimit që merret në ueb faqen e ZÇK-së
 - 1.2 certifikatën e regjistrimit të medias në organin kompetent në Republikën e Kosovës;
 - 1.3 licencën për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e shërbimeve mediale audio-vizuele, të lëshuar nga organi kompetent në Republikën e Kosovës;
 - 1.4 certifikatën e numrit fiskal;
 - 1.5 letërnjoftimin e vlefshëm të udhëheqësit të medias apo të personit të autorizuar, të lëshuar nga organi kompetent në Republikën e Kosovës;
 - 1.6 raportin e gjashtë (6) mujorit të fundit të llogarisë bankare të medias;
 - 1.7 si dhe dokumente apo dëshmi të burimeve tjera të financimit/mbështetjes nga donatorët tjerë, sipas kërkesës së ZÇK-së.

Neni 14

Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve

1. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit me vendim themelon Komisionin për shqyrtimin e aplikacioneve të Mediave për Komunitetet.
2. Komisioni nga paragrafi 1. i këtij neni përbëhet nga pesë (5) anëtarë.
3. Komisioni për punën e tij i raporton Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.

Neni 15
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni ka për detyrë zhvillimin e të gjitha procedurave për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të dorëzuara nga Mediat, dhe bën përzgjedhjen e Mediave fituese të cilat i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë Program.
2. Komisioni brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh kryen të gjitha procedurat e shqyrtimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së Mediave fituese.
3. Pas përfundimit të procedurave të përzgjedhjes, Komisioni në afat prej tri (3) ditësh njofton ZÇK-në me listën e Mediave përfituese.

Neni 16
Kriteret për përzgjedhjen e mediave fituese

1. Komisioni me rastin e shqyrtimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së Mediave fituese, duhet t'i ketë parasysh kriteret si në vijim:
 - 1.1 përvojën dhe kapacitetet e medias në zbatimin e projekteve paraprake;
 - 1.2 pritshmëria dhe kosto.

Neni 17
Shpallja e Mediave përfituese

Pas përfundimit të procedurave të përzgjedhjes, Komisioni shpallë listën e mediave përfituese, të cilën e dorëzon tek ZÇK me qëllim të njoftimit dhe publikimit të saj në ueb faqen zyrtare të Zyrës.

Neni 18
Procedura e ndarjes së mjeteve tek mediat përfituese

Mediat përfituese pas nënshkrimit të marrëveshjes me ZÇK, do t'i ndahen mjetet financiare për zbatimin e projektit pas dërgimit të raporteve të rregullta sipas kërkesës së ZÇK-së, dhe siç parashihet me marrëveshje.

Neni 19
Monitorimi i zbatimit të projekteve të Mediave

1. Monitorimi i zbatimit të projekteve bëhet nga Komisioni monitorues, i cili themelohet me Vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.
2. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë.
3. Mediat përfituese të projekteve, janë të obliguara të dorëzojnë raport narrativ në ZÇK për ecurinë e projektit, ndërsa 30 ditë pas realizimit të projektit janë të detyruar të dorëzojnë raportin përfundimtar narrativ, raportet financiare, dhe të ofrojnë dëshmi (kupon fiskal dhe dëshmi tjera) që dëshmojnë se projekti është realizuar sipas planit, dhe në pajtim të plotë me këtë Program.
4. Mediat përfituese të projekteve, me rastin e dorëzimit të raportit narrativ në ZÇK, raportit narrativ duhet t'ia bashkëngjisin edhe dokumentet, si në vijim:

- 4.1 letërnjoftimin e vlefshëm të udhëheqësit të Medias apo të personit të autorizuar, të lëshuar nga organi kompetent në Republikën e Kosovës;
- 4.2 përshkrimin në mënyrë të detajuar të projektit;
- 4.3 faktuar origjinale me numër fiskal;
- 4.4 pagesat e kryera nëpërmjet njërës prej bankave të licencuara në Republikën e Kosovës;
- 4.5 Marrëveshjet eventuale të cilat i ka nënshkruar me ndonjë Media tjetër për implementimin e projektit
- 4.6 si dhe dokumente tjera të kërkuara sipas nevojës nga ZÇK.

5. Në rast se Mediat përfituese nuk i përmbahen kërkesave të lartcekura, marrëveshja e nënshkruar do të anulohet dhe do të ndërmerren veprimet përkatëse ligjore për keqpërdorimin dhe keq menaxhimin e parasë publike, si dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi, do të kërkohej kthimi i mjeteve financiare të cilat i ka përfituar OJQ-ja me qëllim të realizimit të projektit.

Neni 20

SUBVENCIONET PËR PERSONAT FIZIKË DHE JURIDIKË

1. ZÇK ndan subvencione për personat fizikë dhe juridikë, me qëllim të realizimit të kërkesave dhe projekteve.
2. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, me propozimin e ZÇK-së themelon Komisionin për shqyrtimin e kërkesave dhe projekteve për ndarjen e subvencioneve për personat fizikë dhe juridikë.
3. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë.
4. Komisioni bën shqyrtimin e të gjitha kërkesave nga personat fizikë dhe juridikë, të cilët bëjnë kërkesë në ZÇK për fitimin e subvencioneve.
5. Komisioni për punën e tij i raporton Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.

Neni 21

Kriteret për aplikimin e personave fizikë

1. Të gjithë personat fizikë të cilët aplikojnë për fitimin e subvencioneve në ZÇK, duhet t'i plotësojnë kushtet dhe kriteret si në vijim:
 - 1.1 Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
 - 1.2 Dokumentin e vlefshëm identifikues të Republikës së Kosovës;
 - 1.3 Kopjen e llogarisë bankare të njërës nga bankat në Kosovë;
 - 1.4 Arsyetimi i kërkesës për fitimin e subvencionit apo grantit;
 - 1.5 dokumentet tjera shtesë që dëshmon nevojat tjerat për përfitim të grantit apo subvencionit;
 - 1.6 Si dhe kushtet apo kriteret tjera që kërkohen nga ZÇK.

Neni 22

Kriteret për aplikimin e personave juridikë

1. Të gjithë personat juridikë të cilët aplikojnë për fitimin e subvencioneve në ZÇK, duhet t'i plotësojnë kushtet dhe kriteret si në vijim:
 - 1.1 Te jenë të regjistruar në organin kompetent sipas legjislacionit në fuqi;
 - 1.2 Kopja e dokumentit identifikues të Republikës së Kosovës të personit të autorizuar që përfaqëson personin juridik;

- 1.3 Kopjen e llogarisë bankare në njërin nga bankat në Kosovë;
- 1.4 Arsyetimin e kërkesës për fitimin e subvencionit;
- 1.5 Dëshminë e burimeve të tjera të financimit/mbështetjen nga donatorët tjerë;
- 1.6 Certifikatën valide të numrit fiskal.
- 1.7 Si dhe kushtet apo kriteret tjera që kërkohen nga ZÇK.

Neni 23

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni ka për detyrë zhvillimin e të gjitha procedurave për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të dorëzuara nga personat fizikë dhe juridikë në ZÇK.
2. Komisioni mblidhet së paku një herë në tre (3) muaj për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për fitimin e subvencioneve.

Neni 24

Monitorimi i implementimit të subvencioneve dhe transfereve

1. Monitorimi i subvencioneve dhe transfereve bëhet nga Komisioni monitorues, i cili themelohet me Vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.
2. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë.
3. Personat fizikë dhe juridikë përfitues të projekteve, janë të obliguar të dorëzojnë raport narrativ në ZÇK për ecurinë implementimit të subvencionit apo transferit, ndërsa 30 ditë pas realizimit të subvencionit apo transferit, janë të detyruar të dorëzojnë raportin përfundimtar narrativ, raportet financiare, dhe të ofrojnë dëshmi (kupon fiskal dhe dëshmi tjera) që dëshmojnë se subvencioni apo transferi është realizuar sipas planit, dhe në pajtim të plotë me këtë Program.
3. Në rast se personi fizik apo juridik përfitues nuk i përmbahen kërkesave të lartcekura, marrëveshja e nënshkruar do të anulohet dhe do të ndërmerren veprimet përkatëse ligjore për keqpërdorimin dhe keq menaxhimin e parasë publike, si dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi, do të kërkohet kthimi i mjeteve financiare të cilat i ka përfituar personi fizik apo juridik.

Neni 25

Marrëveshja me përfituesin

1. ZÇK nënshkruan marrëveshje me shkrim me përfituesin e subvencionit/transferit, brenda 30 ditësh nga dita e shpalljes së përfituesve.
2. Marrëveshja me shkrim duhet të përmbajë:
 - 2.1 detajet lidhur me shumën e financimit, kohën e implementimit të projektit, monitorimin e zbatimit dhe raportimin për implementimin e projektit;
 - 2.2 dispozita me të cilat përcaktohet se cili është qëllimi i përfitimit të subvencionit;
 - 2.3 dispozita me të cilën përfituesi obligohet që mjetet financiare të fituara me anë të subvencionit t'i shpenzojë përmes transaksioneve bankare, dhe ato transaksione t'i paraqes në kohën e raportimit tek ZÇK;
 - 2.4 dispozita lidhur me rastet kur mund të ndërpritet marrëveshja dhe
 - 2.5 dispozita me të cilat rregullohet kthimi i mjeteve financiare në rast të prishjes së marrëveshjes.

Neni 26
Auditimi

1. Njësia për Auditim të Brendshëm në Zyrën e Kryeministrit, sipas detyrës zyrtare bënë auditimin e përfituesve lidhur me shfrytëzimin racional të mjeteve financiare.
2. Njësia e Auditimit, përgatit raportin me rekomandimet, lidhur me të gjeturat e auditimit.
3. Auditimi bëhet edhe nga auditorët e jashtëm në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 27
Konflikti i interesit

1. Në rast se me ndonjërin nga anëtarët e Komisionit ekziston konflikti i interesit me rastin e ndarjes së subvencionit, ai anëtar për atë rast ndërrohet dhe caktohet një tjetër anëtar ad hoc për procedurat e përzgjedhjes dhe votimit.
2. Të gjitha rastet e konfliktit të interesit duhet të shumangen, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 28
Ndryshimi dhe plotësimi i këtij vendimi

Ky vendim ndryshohet dhe plotësohet sipas nevojës, me propozim të Zyrës për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit.

Neni 29
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 08/140
Datë: 05.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullore nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullore së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Drin Haraçia emërohet Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë tre (3) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/140
Datë: 05.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Administrimin e Mbeturinave nga Industria e Nxjerrjes së Mineraleve.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/140
Datë: 05.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Rregullimin e Fushës për Produktet Biocide.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/140
Datë: 05.04.2017


Qeveria e Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. prot. 588 datë 01.03.2017, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave shoqërore të KBI "Progres", Prizren të cilat preken nga realizimi i Projektit për ndërtimin e "Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Vllashnje" Zona Kadastrale Vllashnje, Komuna Prizren, sipas tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokolli 294/17 datë 18.01.2017.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Komuna e Prizrenit do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryejë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/140
Datë: 05.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4, 8 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. prot. 221/4 datë 09.03.2017, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës R6 Prishtinë - Hani i Elezit, Sektori C3, Zonat Kadastrale: Paldenicë, Neqavc, Dimcë dhe Hani i Elezit, Komuna Hani i Elezit dhe Zonat Kadastrale: Kovaçec, Bob, Gajre, Kaçanik dhe Gjurgjedell të Komunës së Kaçanikut, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesët përbërëse të këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015 për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Financave.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/140
Datë: 05.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Ministrisë së Integritimit Evropian për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës autorizimin për nënshkrimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
2. I rekomandohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit Ministres së Integritimit Evropian, për nënshkrimin e Marrëveshjes nga paragrafi 1. i këtij vendimi, konform afatit të përcaktuar në Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 14/140
Datë: 05.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 5 të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës autorizimin për nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe Organizatës - Stitching SPARK të Holandës, për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit "IBCM" në Mitrovicë.
2. I rekomandohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për nënshkrimin e Marrëveshjes nga paragrafi 1. i këtij vendimi, konform afatit të përcaktuar në Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 15/140
Datë: 05.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës autorizimin për nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit për financimin dhe drejtimin e zbatimit të projektit: "HERAS -Arsimi i Lartë, Hulumentimi dhe Shkencat Aplikative (Kosovë)" ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim - ADA.
2. I rekomandohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për nënshkrimin e Marrëveshjes nga paragrafi 1. i këtij vendimi, konform afatit të përcaktuar në Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 16/140
Datë: 05.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15 pika 8 të Ligjit Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. prot. 595/3 datë 09.03.2017, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ri alokimi i mjeteve në shumë prej 94,200.00 (nëntëdhjetë e katërmijë e dyqind) euro në buxhetin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me tri (3) marrëveshjet e mirëkuptimit të nënshkruara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe kryetarët e komunave për projekte kapitale.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/140
Datë: 05.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Ministrisë së Integrimit Evropian për nisjen e negociatave për antarësimin e Kosovës në Programet e BE-së: *Erasmus +, COSME, Evropa për Qytetarët dhe Evropa Kreative.*
2. Obligohen institucionet përfituese të programeve të cekura në pikën 1. të këtij vendimi, bazuar në Marrëveshjen Kornizë për Programet e BE-së ndërmjet Kosovës dhe BE-së dhe legjislacionin në fuqi, të kryejnë hapat e nevojshëm procedural për anëtarësim.
3. Ministria e Integrimit Evropian obligohet që të fillojë procedurat e nevojshme për të siguruar rimbursimin e mjeteve financiare për pagesën e anëtarësimit nga IPA 2017.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/140
Datë: 05.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 129 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik që të vendos lidhur me nivelin e përdorimit të platformës elektronike nga ana e autoriteteve kontraktuese, varësisht nga vlerësimet e KRPP-së.
2. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik do të vlerësojë dhe vendosë për nivelin e aplikimit të platformës, përkatësisht moduleve të platformës së prokurimit elektronik, duke u mbështetur në analizat dhe rekomandimet e sektorit të IT-së së KRPP-së dhe/ose vlerësimeve nga monitorimi i zbatimit të platformës.
3. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, është i autorizuar që të nxjerr vendime të cilat e rregullojnë aplikimin e masave të përkohshme të cilat konsiderohen të nevojshme për rritjen e efikasitetit të përdorimit të platformës elektronike.
4. Vendimet e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik do të jenë obligative për autoritetet kontraktuese dhe për operatorët ekonomikë të cilët marrin pjesë në aktivitetet e prokurimit publik në Institucionet e Republikës së Kosovës.
5. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik obligohet që, përmes Ministrisë së Financave, çdo tre muaj të njoftojë Qeverinë e Republikës së Kosovës mbi shkallën e përmbushjes së objektivave lidhur me aplikimin e moduleve të prokurimit elektronik.
6. Ky vendim vlen për vitin 2017.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë